

**MARKETING & DISTRIBUTION**

Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km 10, Kashar  
Rruga Iliria, Nr.53  
Tel: +355 48 202 336  
e-mail : info@markdist.com  
web: www.markdist.com

Nr. Identifikimi: J72124001N

Prot.Nr . .....

**VENDIM**  
**I ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË**  
**“MARKETING & DISTRIBUTION” SHPK**

Sot, më datë 01.12.2023, Asambleja e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë “MARKETING & DISTRIBUTION” SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar në QKB me Numër Unik të Identifikimit (NUIS) J72124001N, me adresë, Autostrada Tiranë - Durrës, Km.10, Kashar, Tiranë, Shqipëri, zhvilloi mbledhjen në zyrën e ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë, në Tiranë.

Të pranishëm në mbledhjen e thirur nga **administratori Z. Besnik Nushi**:

- **Zj. Vilma Nushi**, zotëruese e 100 % të kapitalit të shoqërisë “MARKETING & DISTRIBUTION” SHPK.

Duke qenë se në mbledhje është i pranishëm Ortaku i Vetëm që përfaqëson 100% të kapitalit të Shoqërisë mbledhja konsiderohet e vlefshme dhe vendimet e saj plotësisht të rregullta:

**Rendi i ditës:**

- 1) Miratimi i nisjes së procedurës për shqyrtimin e mundësisë për zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë “MARKETING & DISTRIBUTION” SHPK me anë të kontributeve në natyrë, me burime nga jashtë shoqërisë, duke bashkuar dy ortak të rinj.
- 2) Miratimi i modaliteve të zmadhimit të kapitalit të Shoqërisë.
- 3) Emërimi i Ekspertit Vlerësues të licencuar, për vlerësimin e pasurive të paluajtshme që do të shërbejnë për zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë.
- 4) Emërimin e Ekspertit Kontabël të Miratuar i cili do të hartoj Raportin e Vlerësimit dhe do të përcaktojë ndryshimet e kapitalit të Shoqërisë.
- 5) Dhënia e miratimit ndaj administratorit **Z. Besnik Nushi**, për kryerjen e të gjitha veprimeve dhe firmosjen e të gjitha akteve të nevojshme për realizimin e qëllimit të këtij vendimi.
- 6) Autorizimi i administratorit të shoqërisë **Z. Besnik Nushi**, për kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme për realizimin e qëllimit të këtij vendimi dhe regjistrimin e tij në QKB.

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, duke pasur parasysh aktivitetin e Shoqërisë dhe duke evidentuar ecurinë e saj aktuale dhe në të ardhmen, mbështetur në Statutin e shoqërisë “MARKETING & DISTRIBUTION” SHPK dhe në Ligjin Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, me qëllim krijimin e kushteve optimale në arritjen e objektivave tregtare të Shoqërisë, për të forcuar kapacitetet teknike dhe organizative, për të siguruar mundësi për kontribute shtesë, për rritje të kapitalit dhe burimeve financiare, për nevojat që mund të kërkojnë në vijim në mbështetje të veprimtarisë së aktivitetit të Shoqërisë, pas shqyrtimit të çdo pike të rendit të ditës:



**MARKETING & DISTRIBUTION**

Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km 10, Kashar  
Rruga Iliria, Nr.53  
Tel: +355 48 202 336  
e-mail : info@markdist.com  
web: www.markdist.com

Nr. Identifikimi: J72124001N

**VENDOSI:**

- 1) Të miratojë vendimin për nisjen e procedurës për shqyrtimin e mundësisë për zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë “MARKETING & DISTRIBUTION” SHPK me anë të kontributeve në natyrë, me burime nga jashtë Shoqërisë, duke bashkuar dy ortak të rinj.
- 2) Të miratojë modalitetet e zmadhimit të kapitalit të Shoqërisë, si më poshtë:
  - Kapitali do të zmadhohet nëpërmjet kontributeve në natyrë të personave të tretë:
    - Zj. Niki Gleoudi, shtetase Greke, lindur më 03.10.1968 në Selanik, mbajtëse e pasaportës me nr. personal AT3179183;
    - Zj. Dorothea Gleoudi, shtetase Greke, lindur më 02.06.1972 në Selanik, mbajtëse e pasaportës me nr. personal AT1637447.
  - Kapitali do të zmadhohet nëpërmjet kontributeve në natyrë, me anë të kalimit në favor të Shoqërisë të pasurive të paluajtshme me të dhëna:
    - Pasuri e paluajtshme: Nr. i Pasurisë 95/7, tokë “Arë”, Sipërfaqja Totale 8020 m2, Adresa e Pasurisë Bashkia Tiranë, Katund i Ri, Kashar. Në pronësi të Niki Gleoudi 1/2 pjesë dhe Dorothea Gleoudi 1/2 pjesë;
    - Pasuri e paluajtshme: Nr. i Pasurisë 95/8, tokë “Arë”, Sipërfaqja Totale 3500 m2, Adresa e Pasurisë Bashkia Tiranë, Katund i Ri, Kashar. Në pronësi të Niki Gleoudi 1/2 pjesë dhe Dorothea Gleoudi 1/2 pjesë;
    - Pasuri e paluajtshme: Nr. i Pasurisë 95/25, tokë “Arë”, Sipërfaqja Totale 1251 m2, Adresa e Pasurisë Bashkia Tiranë, Katund i Ri, Kashar. Në pronësi të Niki Gleoudi 1/2 pjesë dhe Dorothea Gleoudi 1/2 pjesë.
    - Pasuri e paluajtshme: Nr. i Pasurisë 95/27 , tokë “Arë”, Sipërfaqja Totale 2329 m2, , Adresa e Pasurisë Bashkia Tiranë, Katund i Ri, Kashar. Në pronësi të Niki Gleoudi 1/2 pjesë dhe Dorothea Gleoudi 1/2 pjesë.
  - Personat e tretë (Zj. Niki Gleoudi dhe Zj. Dorothea Gleoudi) do të bëhen Ortak të Shoqërisë dhe pjesëmarrëse në kapitalin e Shoqërisë në përputhje me vlerën e kontributeve të ofruara në natyrë dhe sipas përcaktimeve në Raportin e Vlerësimit.
- 3) Të emërojë Ekspertin Vlerësues të licencuar Elvira Serjanaj, me Nr. Licence VP.0258/1 datë 13.05.2013 dhe Vp.1247/1 datë 30.05.2019 i cili do të vlerësojë pasuritë e paluajtshme që do të shërbejnë për zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë.
  - Raporti i vlerësimit të pasurive të paluajtshme, do t'i bashkangjitet Raportit të Vlerësimit të Ekspertit Kontabël të Miratuar, i cili do të përcaktojë ndryshimet e kapitalit të Shoqërisë.
- 4) Të emërojë Ekspertin Kontabël të Miratuar Rezart Llukaçej, Auditues Ligjor (EKR) pranë shoqërisë Kreston Albania Sh.p.k, i cili do të hartojë Raportin e Vlerësimit që do të shërbejë si bazë për rritjen e kapitalit të Shoqërisë dhe do të përcaktojë ndryshimet e kapitalit të Shoqërisë dhe përqindjen e pjesëmarrjes në kapitalin e Shoqërisë të ortakëve të rinj dhe ortakut ekzistues.

**MARKETING & DISTRIBUTION**

Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km 10, Kashar  
Rruga Iliria, Nr.53  
Tel: +355 48 202 336  
e-mail : info@markdist.com  
web: www.markdist.com

Nr. Identifikimi: J72124001N

- *Raporti i vlerësimit të Ekspertit Kontabël të Miratuar do të paraqitet për miratim përpara Asamblesë së Ortakut të Vetëm.*
- 5) Të autorizojë administratorin Z. Besnik Nushi, për kryerjen e të gjitha veprimeve dhe firmosjen e të gjitha akteve të nevojshme për realizimin e qëllimit të këtij vendimi.
- 6) Të autorizojë administratorin Z. Besnik Nushi, për kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme për realizimin e qëllimit të këtij vendimi dhe regjistrimin e tij në QKB.

*Meqënëse nuk kishte më probleme për të diskutuar, mbledhja u deklarua e mbyllur.  
Ortaku i Vetëm i pranishëm përfaqëson 100 % të kuotave të kapitalit të Shoqërisë dhe për këtë arsye, konsiderohet se vendimet e kësaj mbledhje janë të vlefshme.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të Ortakut të Vetëm.*

**SHOQËRIA "MARKETING & DISTRIBUTION" SHPK  
ORTAKU I VETËM**

**VILMA NUSHI**

